



Deklaratë për shtyp - 359/05/2020

09.05.2020
Faqja 1 nga 7

Plani i Nordrhein-Westfalen hyn në fuqi / Lehtësimi gradual i masave kundër koronavirusit do të fillojë në javën në vazhdim

Zyra për shtyp e
kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

**Rregullorja e aktualizuar e Republikës për mbrojtjen ndaj
koronavirusit hyn në fuqi / Më shumë nxënës rikthehen në shkolla /
Hapje graduale e sektorit të kujdesit ditor të fëmijëve/ Hapje ndër të
tjera në sektorin e gastronomisë, tregtisë dhe shërbimeve**

Qeveria e Republikës ju informon:

Duke filluar nga dita e hënë (11 Maji 2020) do të zbatohen lehtësime të tjera të masave kundër koronavirusit në Nordrhein-Westfalen, si pjesë e planit të koordinuar të moderuar për Nordrhein-Westfalen të qeverisë së Republikës. Këto përfshijnë, ndër të tjera, hapjen në kushte të rrepta të kufizimit të kontaktit të personave nga dy familje, hapjen e bizneseve pavarësisht madhësisë së tyre, ambienteve të gastronomisë të brendshme dhe të jashtme, sallave të sportit dhe palestrave. Është gjithashtu e mundur që nxënësit e tjerë të ndjekin sërish mësimin në shkolla. Sektori i kujdesit ditor për fëmijë gjithashtu do të zgjerohet gradualisht që prej 14 Majit 2020. Lehtësime të tjera do pasojnë në fazat e tjera si përshembull rregulloret në lidhje me vizitat në spitale, ambiente rehabilituese dhe kujdesi nën masa të rrepta që prej 20 Majit 2020 ose hapja e hoteleve dhe pensioneve që prej 18 Majit 2020.

Me planin për Nordrhein-Westfalen, masat kundër koronavirusit do të lehtësohen në Nordrhein-Westfalen në ditët dhe javët në vazhdim. Plani tregon datat e synuara të fazave të ndryshme për sektorë individualë, të cilat do të implementohen sipas zhvillimit të mëtejshëm të infeksionit. Kjo qasje i ofron qytetarëve të Nordrhein-Westfalen mbrojtje shëndetësore si dhe parashikueshmëri dhe besueshmëri për jetën publike dhe ekonomike. Qeveria e Republikës mbështetet në përgjegjësinë personale të njerëzve. Hapat do të ndodhin nën vlerësimin e vazhdueshëm dhe me kushtëzimin e qartë të përhapjes së infeksionit. Datat e përmendura më lart janë qartësisht data për të cilat duhen marrë parasysh devijime.

Rregulloret përkatëse ligjore (Versioni i ri i rregullores për mbrojtjen nga koronavirusi, rregullorja për kujdesin nga koronavirusi dhe rregullorja për udhëtimin në lidhje me koronavirusin) janë deklaruar ligjërisht dhe publikuar në ditën e shtunë (9 Maj 2020). Këto janë të gatshme këtu tek www.land.nrw:

[Versioni i ri i rregullores për mbrojtjen nga koronavirusi](#)

[Rregullorja për kujdesin nga koronavirusi](#)

[Rregullorja për udhëtimin në lidhje me koronavirusin](#)

Gjithashtu e gatshme online: [Shtojcë: Standartet për mbrojtjen nga infeksioni dhe të higjienës për CoronaSchutzVO NRW](#)

Rregullat e detajuara

Proçedura hap pas hapi e mëposhtme është mundësuar për planin për Nordrhein-Westfalen nga qeveria e Republikës, implementimi i të cilit është subjekt i zhvillimit të përhapjes së infeksionit:

1. Ndalimi i kontaktit dhe rregullat e sjelljes

Nga **11 Maji** e në vijim, kufizimet aktuale të kontaktit do të zhvillohen më tej në mënyrë që të jetë e mundur që pjesëtarët e dy familjeve të takohen në vende publike. Rregullorja e përgjithshme për distancën prej 1.5 metrash vazhdon të jetë e vlefshme, duke përfshirë detyrimin e pajisjes me maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës në raste të caktuara.

2. Kujdesi për fëmijët

Duke filluar nga dita e enjte, më datë 14 Maj do të hapet gradualisht sektori i kujdesit ditor të fëmijëve, fillimisht për fëmijët parashkollorë që përmbushin kushtet e ligjit të Bildungs- und Teilhabegesetz dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e rrezikuar nga paaftësi madhore. Për më tepër, ambientet për kujdesin ditor të fëmijëve do të hapen për fëmijët që kanë arritur moshën dy vjeç dhe për projektet e urës. Kujdesi privat i organizuar nga prindërit lejohet gjithashtu, me kusht që fëmijët të qëndrojnë në të njëjtat grupe.

Në një hap tjetër, të gjithë fëmijët e tjerë parashkollorë do të përfshihen përsëri në kujdesin ditor që prej 28 Majit. Hapje të mëtejshme janë planifikuar në qershor.

3. Shkollat

Duke filluar nga e hëna, më datë 11 Maj 2020, do të rikthehen kryesisht në shkollë, nxënësit e shkollave të mesme dhe shkollave gjithëpërfshirëse, të cilët do t'u nënshtrohen Abituri-t në vitin shkollor pasardhës 2020/21.

Për më tepër, nëse do të ekzistojë hapësira dhe kapaciteti i stafit, do të jetë i mundshëm trajnimi i grupeve të tjera ose klasave nga klasa e pestë e deri tek nxënësit e fazës prezantuese në një sistem në rotacion të përditshëm. Për më tepër, një deri në dy vite klasash nga klasat 5 deri në 9 rikthehen tek format shkollore të nivelit të dytë të ulët (Hauptschule, Realschule, Sekundarschule, PRIMUS and Gemeinschaftsschule) në një sistem në rotacion të përditshëm. Deri në plotësimin e provimeve të decentralizuara, të cilat do të zëvendësojnë provimet e klasës së 10 këtë vit, viti shkollor i 10 do të vazhdojë të ketë prioritet në mësimdhënie. Pas kësaj, kjo klasë do të vazhdojë të përfshihet në mësimdhënien në sistemin në rotacion ditor.

Gjithashtu duke filluar nga **e hëna më 11 Maj**, viteve nga 1 deri në 4 do t'u jepet sërish mësim në shkollat fillore në rotacion të rregullt ,me nga një vit klase në ditë. Mësimi i hapur gjithë ditën dhe shërbime të tjera kujdesi do të rinisin paralelisht me mësimet dhe kujdesin urgjent brenda hapësirës ekzistuese dhe burimeve të personelit.

Njësoj si në shkollat fillore, **nga 11 Maji e në vijim** nxënësve në vitet nga 1 deri në 4, do t'u jepet mësim në shkolla për fëmijë me nevoja të veçanta në rotacion të rregullt me një grup klase në ditë (me përjashtim të fushave të veçanta të zhvillimit mendor dhe të zhvillimit fizik dhe motorik). Nëse është e mundur, nxënësit nga një deri në dy vite klasash nga klasat 5 deri në 9 duhet të rikthehen gjithashtu në një sistem rotacioni.

4. Ambiente stacionare të shëndetit dhe kujdesit

Duke patur parasysh **Ditën e Nënës**, vizitat në shtëpitë e të moshuarve dhe të kujdesit janë bërë të mundura sërish që nga e shtuna, më datë **9 Maj**, në kushte të rrepta higjiene. Vizitorët janë të këshilluar të telefonojnë ambientet më përpara, në mënyrë që t'i planifikojnë më mirë vizitat e tyre për sa i përket mbrojtjes nga infeksioni dhe higjiensës.

Duke filluar nga **20 Maji**, hapja vlen dhe për spitalet dhe për qendrat e rehabilitimit dhe të kujdesit.(Maksimumi një vizitë në ditë dhe maksimumi dy pacientë).

Institucionet mund të caktojnë periudha vizite. Shërbimet mund të ndalojnë vizita për të gjithë institucionin ose për departamente individuale nëse e kërkon situata aktuale e infeksionit. Spitale individuale mund të lejojnë vizitat duke filluar që **nga 11 Maji**.

5. Sporti dhe koha e lirë

Fazat e mëtejshme do të zbatohen për sektorin e sportit dhe të kohës së lirë:

Tashmë prej ditës së enjte (më datë 7 Maj), sportet dhe veprimtaria e trajnimit me mungesë kontakti, lejohen përsëri për sa kohë sporti zhvillohet në mjedise sportive private ose publike të hapura ose në hapsira të hapura. Duhet të garantohet një distancë prej 1.5 metrash midis personave dhe mbikqyrja e masave të rrepta të mbrojtjes nga infeksioni dhe të higjienës. Dushet, dhomat e larjes, dhomat e zhveshjes, dhomat sociale dhe dhoma të tjera të përbashkëta janë të ndaluara momentalisht. Vizitat nga spektatorët janë të ndaluara tani për tani. Gjithsesi për të hyrë në një mjedis sportiv, fëmijët nën moshën 14 vjeç duhet të shoqërohen nga një i rritur.

Hipizmi lejohet në ambiente dhe në salla të mbyllura hipizmi.

Duke filluar nga 11 Maji, do të bëhet e mundur në kushte të rrepta distance dhe higjienë hapja e palestrave dhe e shkollave të baletit si dhe e sallave sportive/dhomave të kurseve për zbavitje pa kontakt dhe sportesh në grup.

Pishinat e hapura mund të rifillojnë aktivitetin që **prej 20 Majit** në kushte të rrepta distance dhe higjienë – me përjashtim të pishinave të argëtimit.

Duke filluar **nga 30 Maji**, veprimtaria e sporteve me kontakt të pashmangshëm fizik dhe në dhoma të mbyllura do të lejohet sërish, gjithashtu dhe veprimtaria në pishina të mbyllura. Konkursat sportive për fëmijë, të rinj dhe amatorë do të lejohen njëkohësisht gjithashtu – përdorimi i dhomave të zhveshjes dhe i mjediseve sanitare do të lejohet duke iu nënshtruar disa kushteve.

6. Gastronomia, Hotelet, Turizmi

Për gastronominë, hotelierinë dhe turizmin synohet një hapje me faza.

Duke filluar nga 11 Maji do të lejohen sërish:

- Veprimtaria e restoranteve, pubeve, tavernave, bar-rostiçerive, kafeneve, kafeneve që shërbejnë akullore, mensave publike, gjithashtu dhe kantinave dhe mjediseve të tjera të shërbimit të ushqimit me kusht që të sigurohet pajtimi me standartet e

mbrojtjes nga infeksionet dhe të higjienës si dhe të mbajtjes së distancës së kërkuar siç është udhëzuar sektori i gastronomisë nga Ministria e Shëndetësisë.

Vetëm personat për të cilët nuk është ndaluar kontakti (përshembull familje ,dy bashkësi familjare) mund të ulen në një tavolinë.

Bufetë me ushqim të hapur nuk lejohen.

- Qëndrimi dhe shfrytëzimi turistik në apartamente dhe shtëpi pushimi si dhe në kamping (duke respektuar kufizimet e kontaktit).
- Hapja e parqeve të kohës së lirë (me plan të aprovuar higjiene), marrja me qira e anijeve të ekskursionit, biçikletave dhe varkave.

Duke filluar nga 18 Maji, hotelet, pensionet, bujtinat për të rinj dhe mjedise të ngjashme akomodimi mund të hapen gjithashtu për turistë që janë rezidentë në Gjermani. Kjo është subjekt i rregulloreve të rrepta analoge me ato të gastronomisë, me standartet e mbrojtjes nga infeksionet dhe të higjienës siç janë udhëzuar nga Ministria e Shëndetësisë si dhe me garancinë e rregulloreve të distancimit dhe të kufizimeve të kontaktit. Me datë të synuar që prej Rrëshajëve (30 Maji), hapja e banjove termale dhe pishinave, pishinave për zbavitje dhe mjediseve të mirëqënies duhet të lejohet sërish sipas planeve të bëra posaçërisht për mbrojtjen nga infeksionet.

Baret, klubet, diskot dhe bordellot janë të mbyllura deri në një njoftim të dytë.

7. Tregtia dhe shërbimet

Bizneset, pavarësisht madhësisë së tyre, mund të rihapen prej **11 Majit**, duke iu nënshtruar rregulloreve të higjienës dhe të distancës (1 person për sipërfaqje shitje prej 10 metër katror). Kjo vlen gjithashtu për kozmetikën, sallonet e thonjve, të manikyrit dhe masazheve duke iu nënshtruar standarteve e rrepta të mbrojtjes nga infeksionet dhe higjienës të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Kryerja e tatuazheve qëndron e ndaluar.

8. Evente madhore dhe mbledhje

Eventet madhore (si përshembull festivalet popullore, panaire, festivale rruge, fshati dhe qyteti, ndeshje qitje, festivale verërash dhe festime të ngjashme) janë të ndaluara deri **më 31 Gusht**. Për mbledhjet vlejné rregulloret e tanishme të distancës.

Me datë të synuar që prej 30 Majit, mund të zhvillohen sërish panairët dhe kongreset e tregtisë, me plan mbrotje dhe numër të limituar vizitorësh dhe pjesëmarrësish.

9. Planet në lidhje me kulturën

Duke filluar nga 11 Maji, lejohen koncertet e vogla dhe performancat e tjera publike në qiell të hapur, ose në bazë të një plani të rreptë higjienë pas autorizimit të autoriteteve, edhe në ndërtesa.

Në shkollat e muzikës ansamblet me maksimalisht 6 pjesëmarrës janë gjithashtu të mundshme.

Provat në institucione kulturore lejohen nën kushtet mbrojtëse, me përjashtim të koreve dhe orkestrave me instrumente frymore për shkak të rrezikut të veçantë të infektimit.

Duke filluar nga **30 Maji**, do të lejohet sërish hapja e kinemave, teatrove, shtëpive të operës me kusht që të garantohet distanca minimale prej 1.5 metrash midis vizitorëve dhe të ketë një plan hyrje.

Shfrytëzimi në rritje i punonjësve të shërbimit duhet të parandalojë grumbullimin në zonat e pritjes dhe të pushimit.

Për teatrot e mëdha, operat dhe sallat e koncerteve ku përshtatja me kushtet e pandemisë kërkon kohë përgatitje paksa më të gjatë, është realist një rifillim i veprimtarisë së rregullt të performancave në fillim të sezonit tjetër prej **1 Shtatorit**, siç është situata për të gjitha eventet madhore.

10. Universitetet

Për sa i përket veprimtarisë së mësimdhënies dhe ekzaminimeve, kufizimi për pranueshmërinë e eventeve të pjesëmarrjes "i dhomave të veçanta, pajisjeve ose kushteve të tjera të veçanta" do të ngrihet që **prej 11 Majit**.

Veprimtaria e mësimdhënies dhe ekzaminimeve në sektorin e shëndetësisë dhe në shkolla, institute dhe mjedise të ngjashme që ofrojnë trajnim profesional në sektorin publik lejohet sërish sipas kushteve të caktuara. Në semestrin e verës, universitetet i zhvillojnë leksionet kryesisht dixhitalisht.

11. Institucionet arsimore jashtëshkollore

Duke filluar nga 11 Maji lejohen gjithashtu në dhoma të mëdha në kushte të rrepta distance dhe higjienë dhe me një maksimum prej 100 pjesëmarrësish eventet në qendrat e edukimit për të rritur dhe institucione të tjera edukative jashtëshkollore private, publike dhe kishtarë ,duke përfshirë ekzaminimet. Aktivitetet sportive për fëmijë dhe të rritur kanë rifilluar që prej 7 Majit.

Duke filluar nga 30 Maji, lejohet përsëri një veprimtari e rregullt e limituar e punës të së rinjve, punës kulturore të së rinjve, punës sociale të së rinjve dhe mbrojtja edukative e fëmijëve dhe të rinjve. Ditët e pushimit mund të zhvillohen kryesisht lokalisht, gjithashtu dhe me udhëtime në grup (përshembull të organizuara nga shoqata rinore).

12. Shërbimet fetare

Duke marrë parasysh planet e higjienës dhe të mbrojtjes të kishave dhe komuniteteve fetare, shërbimet kishtare zhvillohen sërish që prej 1 Majit.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)